



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/1246

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga u.d.Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Paneliste Individuale, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Eko Ing SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontrate ose të një konkursi të projektimit të Kuvendi Komunal – Rahovec në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Dekorimi i qytetit të Rahovecit për festat e fund vitit me numër të prokurimit 623-24-12444-2-3-6, me 19.02.2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE Eko Ing SH.P.K., me nr. 2024/1246, e datës 19.12.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit ‘‘Dekorimi i qytetit të Rahovecit për festat e fund vitit’’ me numër të prokurimit 623-24-12444-2-3-6.

2. Mbetet në fuqi B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK Kuvendi Komunal – Rahovec, ndërkaj aktiviteti i prokurimit Dekorimi i qytetit të Rahovecit për festat e fund vitit me numër të prokurimit 623-24-12444-2-3-6 .

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 25.11.2024 Kuvendi Komunal – Rahovec, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin Dekorimi i qytetit të Rahovecit për festat e fund vitit me numër të prokurimit 623-24-12444-2-3-6.

Me 05.12.2024, AK (me të dhëna si më sipër) ka publikuar Njoftimi mbi vendimin (B58) ku ka shpërblyer me kontratë OE Gzimi – Garten – Und Landschaftsbau SH.P.K. në vlerë totale të kontratës 8,834.00 Euro.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur, me llojin e kontratës shërbime me vlerë të kontratës 9,980.00 euro.

Me 10.12.2024 OE Eko Ing SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Ku Autoriteti Kontraktues me 10.12.2024 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 19.12.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Eko Ing SH.P.K., me numër protokoli 2024/1246 lidhur me aktivitetin e prokurimit Dekorimi i qytetit të Rahovecit për festat e fund vitit me numër të prokurimit 623-24-12444-2-3-6.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Eko Ing SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

1. Pretendimi për Kapacitetet Ekonomike dhe Financiare:
 - Kërkesa: Komisioni kërkon që Operatori Ekonomik të ofrojë dëshmi të kënaqshme për qarkullimin vjetor të Operatorit Ekonomik gjatë tre viteve të fundit, në vlerë jo më pak se 19,500.00 Euro.
 - Dëshmia e ofruar: Deklaratat Tatimore vjetore dhe raport nga banka, të cilat janë të vulosura dhe të nënshkruara si dokumente origjinale. Kjo pikë është e përmbushur dhe nuk ka asnjë dilemë për kundërligjshmëri në interpretimin e komisionit vlerësues. Dokumenti 7 përmban të dhëna të plota dhe transparente për vitet 2022, 2023, 2024, me qarkullim total prej 178,127.36 euro.
2. Pretendimi për Kapacitetin Teknik dhe Profesional:
 - Kërkesa: Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjetet e punës në dispozicion për realizimin e shërbimeve.

- Dëshmitë e ofruara: Dy kamionë me auto-shportë, për të cilët janë ofruar dokumente të nënshkruara dhe të vulosura nga Operatori Ekonomik që vërtetojnë disponimin e mjeteve.
 - Dëshmia e ofruar: Dokumenti i listës origjinale të shërbimeve dhe dokumentet që përfshijnë lejen e qarkullimit të automjeteve, që janë të njohura dhe të njoftuara ndërkombëtarisht për katër kamionë me auto-shporta. Kjo pikë është tejkaluar dhe është interpretuar gabimisht nga komisioni vlerësues.
3. Pretendimi për Mungesën e Kualifikimeve të Tenderuesit "Fitues":
- Kërkesa: OE "fitues" duhet të përmbushë minimumin e kërkesave për aktivitetet teknike dhe profesionale.
 - Pretendimi: OE "fitues" nuk ka ushtruar kurrë veprimtari në fushën e instalimeve dhe ndriçimeve elektrike, dhe aktivitetet e tij primare janë prodhimi i betonit. Kjo është në kundërshtim me kërkesat e tenderit, pasi shifrat dhe përshkrimi i veprimtarive të tij nuk janë të lidhura me fushën e kërkuar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 24.12.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2024/1246, ndërsa me datë 25.12.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/1246, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet lidhur me rekomandimin e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk ka kthyer përgjigje lidhur me mendimin e ekspertit.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e Eko Ing SH.P.K., ekspertit shqyrtues përmes raportit nr. 2024/1246 ka vlerësuar si në vijim:

EKO ING Sh.P.K. ka paraqitur një ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) kundër Kuvendit Komunal Rahovec, lidhur me aktivitetin e prokurimit për "Dekorimi i Qytetit të Rahovecit për Festat e Fundvitit", duke pretenduar shkelje të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Ankuesi ka theksuar se është eliminuar padrejtësisht dhe në mënyrë të kundërligjshme nga procesi i tenderimit, pavarësisht përmbushjes së plotë të kushteve të përcaktuara në dokumentet e tenderimit.

ANALIZA E EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti shqyrtues ka analizuar me kujdes pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues dhe ka gjetur si në vijim:

1. Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar

Kërkesa e AK: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme se qarkullimi vjetor gjatë tre viteve të fundit është jo më pak se 19,500.00 euro. Dëshmia e kërkuar: Deklaratat tatimore vjetore të dorëzuara në ATK ose raport nga banka e vulosur dhe e nënshkruar origjinale nga ndonjë bankë e licencuar në Kosovë.

Pretendimi i AK-së: OE nuk ka ofruar deklaratat tatimore vjetore të dorëzuara në ATK, siç është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues (pra formularin CD). Në vend të kësaj, OE ka dorëzuar një dokument të quajtur "Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve tjera" që nuk përmbush kërkesat e përcaktuara.

Vlerësimi i Ekspertit Shqyrtues: Pas analizimit të dokumenteve të tenderit eksperti shqyrtues sqaron se dokumenti i dorëzuar nga OE tregon qarkullim vjetor mbi shumën minimale të kërkuar.

Eksperti shqyrtues po ashtu sqaron se në rast se AK kishte dyshime lidhur me dokumentin e dorëzuar, në pajtim me nenet 59-72 të LPP-së, duhej të kërkohej sqarim të tenderit për të verifikuar përputhjen me kriteret minimale financiare.

2. Kërkesat Teknike dhe Profesionale

Kërkesa e AK-së: OE duhet të posedojë Dy (2) Kamionë me auto-shportë për realizimin e shërbimeve.

Dëshmia e kërkuar: Lista origjinale e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik e pajisjeve – mjeteve të punës në dispozicion për realizimin e shërbimeve . Dy (2) Kamionë me auto shportë;

Duhet të dorëzohet dëshminë që janë në dispozicion të Operatorit Ekonomik për realizimin e punëve dhe shërbimeve (dëshmitë me foto se mjetet janë në dispozicion të Operatorit Ekonomik dhe Libreza e regjistrimit të automjetit e cila regjistrohet duhet të jete me afate të regjistrimit) ose në rast se Operatori Ekonomik nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofrojë marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jete në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët; Lista origjinale e pajisjeve e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Marrëveshje për qira të pajisjeve nëse nuk janë pronë e OE, me vlefshmëri për tërë kohëzgjatjen e kontratës dhe e nënshkruar nga të dyja palët.

Pretendimi i AK: OE ka dorëzuar një listë të mjeteve, por nuk ka bashkëngjitur fotot e kërkuara. Një nga automjetet e paraqitura ka regjistrim të skaduar.

Marrëveshjet e bëra për marrjen me qira të pajisjeve nuk janë shoqëruar me fotot përkatëse, siç kërkohej në dokumentet e tenderit.

Vlerësimi i Ekspertit Shqyrtues: Eksperti shqyrtues ka analizuar dokumentet në platformën e-prokurimi dhe vëren se AK nuk ka dhënë një arsyetim të plotë dhe të qartë në lidhje me mopërbushjen e kërkesës së lart cekur në njoftimin mbi eliminim.

Megjithatë, në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim, AK ka specifikuar se në bazë të dëshmive të ofruara ankuesi ka prezantuar dy automjete, ku një nga automjetet kishte regjistrim të skaduar dhe që fotot e pajisjeve nuk ishin dorëzuar, gjë që ishte kërkesë e detyrueshme e tenderit.

Po ashtu në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim, përveç dy pajisjeve të lartcekura AK ka specifikuar se ankuesi ka prezantuar marrëveshje për marrjen me qira të pajisjeve, por as këto nuk janë përcjellë me foto sipas kërkesës së AK-së.

Mbështetur në arsyet e dhëna nga AK dhe analizën në dokumentet në platformën e-prokurimi, eksperti shqyrtues ka vërejtur se dokumentet e përmendura nga AK, dëshmitë e fotove nuk janë prezantuar nga ankuesi. Megjithatë, në pajtim me nenet 59-72 të LPP-së, do duhej të kërkohej sqarim të tenderit. Sqarimet do të kishin ndihmuar në shmangien e dyshimeve dhe mundësinë e eliminimit të padrejtë të OE.

3. Aktiviteti Biznesor

Pretendimi i Ankuesit: Ankuesi pretendon se veprimtaria e OE fitues nuk është në përputhje me natyrën e projektit të tenderuar.

Vlerësimi i Ekspertit Shqyrtues: Eksperti sqaron se disa nga veprimtaritë e OE fitues kanë ngjashmëri me aktivitetin e prokurimit në fjalë.

4. Interpretimi i Neneve 68 dhe 69 të LPP-së

Pretendimi i Ankuesit: Ankuesi pretendon se AK ka shkelur nenet 68 dhe 69 të LPP-së gjatë eliminimit të ofertës së tij.

Vlerësimi i Ekspertit Shqyrtues: Eksperti shqyrtues konstaton se OE ka interpretuar gabimisht dispozitat e neneve 68 dhe 69 të LPP-së, që lidhen me kapacitetet ekonomike, teknike dhe profesionale. Nuk ka prova që AK ka shkelur këto dispozita në mënyrën që pretendon OE. Ankuesi pretendon se AK ka bërë shkelje ligjore me rastin e eliminimit të ofertës së tij.

Përfundim: Eksperti shqyrtues rekomandon që ankesa të pranohet pjesërisht e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim. AK-ja nuk ka shteruar të gjitha mundësitë ligjore për të sqaruar dhe verifikuar përputhjen e dokumenteve të dorëzuara nga OE me kriteret e përcaktuara. Gjatë rivlerësimit, AK duhet të kërkojë sqarime shtesë për të siguruar një proces të drejtë, transparent dhe në përputhje me dispozitat e LPP-së. AK duhet të vlerësojë ofertat duke respektuar parimet e barazisë dhe ekonomicitetit.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohej nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit,

përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrës dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar për faktin se tek kërkest mbi mundësit teknike/profesionale ku janë kërkuar: III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: **Dëshmia e kërkuar dokumentare:** Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të posedojë Mjetet e punës në dispozicion për realizimin e shërbimeve • Dy (2) Kamionë me auto shportë; Dëshmia 1 Lista origjinale e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik e pajisjeve – mjeteve të punës në dispozicion për realizimin e shërbimeve • Dy (2) Kamionë me auto shportë; Duhet të dorëzoj dëshminë që janë në dispozicion të Operatorit Ekonomik për realizimin e punëve dhe shërbimeve (dëshmitë me foto se mjetet janë në dispozicion të Operatorit Ekonomik dhe Libreza e regjistrimit të automjetit e cila regjistrohet duhet të jete me afate të regjistrimit) ose Ne rast se Operatori Ekonomik nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jete në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët; në ofertene OE ankues ka ofruar vetëm një listë (Lista e makinerise) me përshkrim të dy automjeteve 02 automjete në emër të pronarit vet ankuesit Kamion me nr targave: 04-910-GC ku ka bashkangjitur librezën e automjetit sipas validiteti : 10.09.20219 (mbi 4 vite të më hershme) dhe Autokran 04-872-GL sipas librezës së validiteti: 25.05.2019 (mbi 04 vite të më hershme) , ku në përshkrim të këtyre librezave është kamionet me korpe dhe me dy dyer , dhe kamionet dublekabin me 03 dyer. Poashtu ka ofruar një marveshje ku nuk ka datë të caktuar as përshkrim të projektit siq është kërkuar , marveshje e lidhur me Personit juridik B.K per vitin 2023-2024. Kamionit korpe me nr targave 04-785-PE (kamion me shporte dy dyer) , poashtu ka ofruar edhe një marveshje tjetër me MONTING sipas dates 02.12.2024, per projektin në fjalë ku asnjëra nga këto marveshje nuk figuron në listen e ofruar të mjeteve , poashtu në ofertë të OE ankues nuk figuron asnjë fotografi se mjetet janë në dispozicion të OE -se për realizimin e projektit siq edhe kërkohet në NJK dhe DT.

Në këtë rast Paneli shpjegon se i mbështet pjesërisht konstatimet në pretendimet ankimore tek raporti i ekspertizës për çka i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar B58Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – “Kuvendi Komunal Rahovec lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Dekorimi i qytetit të Rahovecit për festat e fund vitit” me numër të prokurimit 623-24-12444-2-3-6.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nënpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I, II dhe III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të ushtrojë Padi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit në Gjykatën Komerciale/Departamentit për çështje Administrative në Prishtinë.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**
- **OE - EKO ING SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: